



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative**

**01nr**

**Dt: 02.04.2015**

Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative të Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 50 shkronjat **d** dhe **f** të Statutit të Komunës së Gjakovës, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Zhvillimit Ekonomik, për formimin e komisionit për verifikimin e dokumentacionit të arkivit të Komunës së Gjakovës, për rastet e kërkesave të palëve për rregullimin e stazhit pensional, me datë 02.04.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

- I.** Formohet Komisioni për verifikimin e dokumentacionit të arkivit të organeve të administratës të Komunës së Gjakovës, i cili është i ndërlidhur me kërkesat e palëve për përvojën e punës dhe kontributet e paguara për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit privat, në këtë përbërje :
  1. Nexhat Shunjaku, kryesues
  2. Selami Tuzi, anëtar
  3. Burim Emra, anëtar
- II.** Ky Komision duhet të angazhohet për verifikimin e dokumenteve të pagesës së kontributeve për sigurimin pensionalo-invalidor, sipas kërkesave të parashtruara nga qytetarët për pajisje me dokument zyrtar me të cilin vërtetohet funksionimi i biznesit privat dhe pagesa e kontributeve për periodën kohore deri në vitin 1999.
- III.** Nëse nuk gjenden dokumentet përkatëse sipas kërkesave të palëve në arkivin e Komunës, ky Komision duhet të bashkëpunon me zyrtarët e Arkivit Ndërkomunal në Gjakovë, për verifikimin e dokumenteve në këtë arkiv, të cilat janë dëshmi për plotësimin e kushteve për njohjen e të drejtës së pensionit të këtyre palëve.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në momentin e revokimit nga organi përkatës .
- V.** Vendimi iu dorëzohet:
  - Kabinetit të Kryetares së Komunës
  - Anëtarëve të komisionit
  - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
  - Arkivit

**Drejtori i DPPA**

**Z. Armend Vokshi**